



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E MBIKËQYRJES NË FUSHËN E DREJTËSISË PENALE DHE
SIGURISË PUBLIKE

Nr. 1556/1 prot.

Tiranë, më 02.07.2024

Lënda: Mbi bashkërendimin e projektligjit “Për Zyrën e Rikuperimit të Aseteve”.

MINISTRISË SË BRENDSHME

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) ka administruar shkresën tuaj nr. 2418/15 prot., datë 13.06.2024, protokolluar me tonën me nr. 1556 prot., datë 19.06.2024, me anë të së cilës dërgoni për bashkërendim projektligjin “Për Zyrën e Rikuperimit të Aseteve” (në vijim, “projektligji”), si dhe relacionin shoqërues.

Nga shqyrtimi i Projektligjit të ridërguar, Zyra e Komisionerit konstaton se në tërësi sugjerimet e dhëna nga ana jonë me shkresën nr. 577/1 prot., datë 13.03.2024, janë marrë në konsideratë dhe janë reflektuar në këtë draft. Megjithatë, vlerësojmë nevojën e disa saktësimeve, të cilat i ridërgojmë si më poshtë vijon:

Sikurse ju kemi sugjeruar dhe në shkresën tonë të mëparshme, Zyra e Komisionerit, ka vlerësuar që nga ana juaj të merren masa për rregullimin e nivelit dhe monitorimit të aksesit në databazat përkatëse. Monitorimi i aksesit dhe kërkimeve nga autoritetet kompetente është i rëndësishëm, pasi çdo institucion, në cilësinë e kontrolluesit në kuptim të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, legjitimohet të aksesojë të dhëna personale, vetëm për aq sa lidhet me qëllimin dhe objektin e veprimtarisë së tij.

Nga ana tjetër, për përmbushjen e këtij kriteri të ligjshëm përpunimi, është e nevojshme që databaza e të dhënave të ndërtohet në mënyrë të tillë që të garantohet konfidencialiteti dhe aksesit i kufizuar në përputhje me qëllimin e përpunimit si dhe të sigurohet gjurmueshmëria

për çdo ndërhyrje në databazat përkatëse. (*Ritheksojmë se ky sugjerim vjen në linjë me Nenin 6, të Direktivës (BE) 2019/1153, të cilën synon të përafrojë projektligji*).

Gjithashtu, sa i përket **nenit 14 të projektligjit**, vërejmë që është reflektuar sugjerimi i Zyrës së Komisionerit, por ndërkohë pika 1, e këtij neni duhet rishikuar, sipas sugjerimit tonë të mëparshëm, i cili nuk parashikon të dhënat e klasifikuara “*sekret shtetëror*”.

Pika 1, e nenit 14, të projektligjit sugjerojmë të jetë me këtë përmbajtje:

“1. Përpunimi i të dhënave personale, (përfshirë edhe ato sensitive) do të kryhet në përputhje me parimet, kriteret, si dhe masat tekniko-organizative të zbatueshme për garantimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara, në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.” (*Sugjerimi i përafshuar dhe me Nenin 5 (3) - Kushtet për akses dhe për kërkime nga autoritetet kompetente dhe Nenin 16 (1) -Përpunimi i të dhënave sensitive, të Direktivës (BE) 2019/1153.*”

Megjithatë, nëse vlerësohet nga ana juaj që përpunimi i të dhënave personale dhe atyre të klasifikuara “*sekret shtetëror*” të qëndrojnë në një nen të vetëm, siç vërehet në projektligjin e dërguar për bashkërendim, atëherë duhet rishikuar titulli i nenit 14, i cili duhet të parashikojë edhe të dhënat e klasifikuara “*sekret shtetëror*” në titullin e tij.

Me reflektimin e propozimeve të mësipërme, ky projektligj do të konsiderohet i hartuar konform legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi